

Standardi Udhëzues ISO 26000 mbi Përgjegjësinë Sociale

Më 1 Nëntor 2010 u prezantua ISO **26000** një nga standardeve ndërkombëtare më të shumëpritur të këtyre viteve, i cili ofron udhëzime si për biznesin ashtu edhe për organizatat e sektorit publik mbi Përgjegjësinë Sociale.



Puna për ISO 26000 nisi në një aktivitet të zhvilluar në Gjenevë, në të cilën Sekretari i Përgjithshëm i ISO-s, Rob Steele ftoi anëtarët e grupit të punës së ekspertëve të cilët zhvilluan standardin, duke përfshirë drejtimin e përbashkët - Kryetar, Jorge ER Cajazeira, dhe zëvendës-kryetar, Staffan Swderberg, parashikuar nga anëtarët e ISO përkatësisht për Braziln (ABNT) dhe Suedinë (SIS). Përfaqësuesit e përdoruesve të mundshëm të standardit gjithashtu morë pjesë, duke përfshirë nga industria dhe qeveritë që kanë shprehur interes të madh dhe mbështetje për një standard udhëzues ndërkombëtar mbi përgjegjësinë sociale.

Rob Steele komentoi: **“Publikimi i ISO 26000 pritet me padurim nga organizatat në të gjithë botën, qofshin ato Sipërmarrje Biznesi apo Organizata të sektorit Publik. Të veprosh në një sjellje të Përgjegjësisë Sociale nuk është më një zgjedhje. Përgjegjësia Sociale po shndërrohet në një nevojë të shoqërisë në mbarë botën. Ajo çka e bën ISO 26000 të vecantë kundrejt iniciativave të shumta ekzistuese të Përgjegjësisë Sociale është se ajo nxjerr në pah një konsensus të vërtet ndërkombëtar në atë çka Përgjegjësia Sociale nënkupton dhe atë që subjekteve kryesore ju nevojitet të për ta zbatuar. Përveç kësaj, ajo është e bazuar gjerësisht në dhënat e të interesuarve, duke përfshirë vendet në zhvillim, bizneset, qeverinë, konsumatorët, fuqinë punëtore, organizata joqeveritare dhe të tjerët”.**

Sipas standardit, perceptimi dhe realiteti i performancës së një Organizate mbi Përgjegjësinë Sociale mund të influencojë, përveç të tjerash në:

- Përparësi Konkurruese;
- Reputacion;
- Mundësi për të tërhequr dhe mbajtur punëtorët ose anëtarët, blerësit, klientët ose përdoruesit;
- Menaxhimi i moralit të punonjësve, angazhimit dhe produktivitetit;
- Këndvështrimin e investitorëve, pronarëve, dhuruesve, sponsorëve si dhe komunitetit financiar;
- Marrëdhëniet me kompanitë, qeverinë, mediat, furnitorët, kolegët, klientë, dhe komunitetin në të cilin operon.

ISO 26000, zhvillimi i të cilit filloi në vitin 2005, është kontribut i Grupit të punës ISO mbi Përgjegjësinë Sociale (ISO WG SR) anëtarësia e të cilit ishte më e madhja dhe gjerësisht e bazuar

në aspektin e përfaqësimit të palëve të interesuara të ndonjë grupi të vetëm formuar deri tani për të zhvilluar një standard ISO.

Gjashtë nga grupet kryesore të palëve të interesuar u përfshinë: industria, qeveria, fuqia punëtore, klientë, organizata joqeveritare dhe shërbimi, kërkimi etj.

Kjo u përgatit nga ekspertet e Anëtarëve të ISO (Organizma Ndërkombetare të Standardeve (NBS) dhe nga Organizata Ndërlidhëse (shoqëri përfaqësuese të bizneseve, kliente ose fuqi punëtore, organizata ndër-qeveritare ose joqeveritare).

Në takimin e fundit të Grupit të Punës, në Korrik të 2010, morë pjesë 450 ekspertë, 201 vrojtues nga 99 vende anëtare të ISO dhe 42 organizata koordinuese të përfshirë në punë.

ISO 26000 jep udhëzime për të gjitha llojet e Organizatave, panvarsisht madhësisë ose vendodhjes, në:

- Koncepte, terma dhe përcaktime përsa i përket Përgjegjësisë Sociale
- Ambjentin, prirje dhe karakteristika të Përgjegjësisë Sociale
- Parimet dhe praktikave që kanë të bëjnë me Përgjegjësinë Sociale
- Çështjet thelbësore dhe Përgjegjësinë Sociale
- Integrimin, zbatimin dhe promovimin e sjelljes së Përgjegjësisë Sociale gjatë organizimit, përmes organizimit dhe praktikave brenda sferës së saj të influencës
- Identifikimin dhe angazhimin me palët e interesuara
- Angazhimet komunikuese, performancën dhe informacionin tjetër të lidhur me Përgjegjësinë Sociale.

ISO 26000 është një Standard Udhëzues i cili nuk mund të përdoret për certifikim, ndryshe nga ISO 9001:2008 (Menaxhimi i Cilësisë) dhe ISO 14001:2004 (Menaxhimi i Mjedisit) i cili mund të përdoret për certifikim.

Për më tepër informacion, Ju lutem vizitoni lidhjet e mëposhtme:

1. http://www.iso.org/iso/iso_catalogue/management_and_leadership_standards/social_responsibility/sr_news-and-articles.htm
2. http://www.iso.org/iso/iso_catalogue/management_and_leadership_standards/social_responsibility/sr_discovering_iso26000.htm
3. http://www.iso.org/iso/iso_catalogue/management_and_leadership_standards/social_responsibility.htm

Ju lutem na kontaktoni:

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit – Rr: “Mine Peza”, 143/3, 1014 Tiranë-Shqipëri, **Tel:** + 355 (04) 222 62 55, **Fax:** + 355 (04) 224 71 77; **E-mail:** info@dps.gov.al.